

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele,**  
**mbajtur më 19.7.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:**  
Llazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:** mr. Alma Mashoviq, (në pushim vjetor).

**Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:**  
Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Emilija Janevska, Vesna Simonovska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 23-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski shpjegoi se z. Mashoviq është me pushime jashtë vendit dhe nuk ka mundësi të marrë pjesë në seancë, sepse siç njoftoi për shkak të lidhjes shumë të dobët të internetit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së njëzet e një të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 22-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2023.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqje të lejes për transmetim në radio ndaj SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar .
4. Propozim për miratimin e formularëve të kërkesës së pajtimit për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja e transmetimit në radio dhe televizion.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV.

6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip për shkelje të nenit 14 nga Ligji për Media.
7. Propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 nga LSHMAAV.
8. Propozim për dhënie miratim për aprovim të vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për Furnizime Publike.
9. Të ndryshme.

Z. Petrushevski njoftoi se nën Pikën Të ndryshme do të japë deklaram në lidhje me kërcënimet anonime të pranuar nga drejtori i Agjencisë për shkak të refuzimit të kërkesës për heqje të lejes të TV Alsat M.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së njëzet e një të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11. 7.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 22-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 11.7.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqje të lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar. Ai ka shpjeguar se transmetuesit i është lëshuar faturë me zbritje prej 25% në pajtim me Vendimin për dhënie të ndihmës financiare (donacion) për transmetuesit në vitin 2022, i cili është miratuar nga Këshilli, por në afatin e parashikuar me Ligj nuk ka paguar kompensimin. Ai tha se shuma që duhet të paguajë është relativisht e ulët, gjegjësisht bëhet fjalë për rreth 21.020,00 denarë. Për këtë arsye, propozohet që të inicohet procedurë për heqje të lejes për transmetim në radio.

Z. Petrushevski tha se shuma është vërtet e vogël dhe kjo në një farë mënyre është tregues i gjendjes së keqe financiare të mediave të vogla. Ai tha se Këshilli i Agjencisë është i obliguar të veprojë nëse kemi shkelje të Ligjit, por shpreson që transmetuesi do të gjejë mënyrë që në 15 ditët e ardhshme të paguaj tarifën vjetore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka filluar procedurë për heqje të lejes për transmetim në radio të SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, nr. 08-437 datë 15.8.2016, për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe ( Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21 ) .

Në pajtim me Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-2864/1 datë 17.7.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin e nenit 80 paragrafi (5) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan tarifën vjetore të lejes sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicimin e procedurës për heqje të lejes, do të marrë Vendim për heqje të lejes për transmetim në radio ndaj SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar . nr 08-437 datë 15.8. 2016 .

Z. Petrushevski pas votimit tha se duhet të informohet transmetuesi për fillimin e procedurës dhe për afatin e fundit deri në të cilin duhet të paguaj kompensimin, prandaj është vërtet turp që për shumë prej 21.020,00 denarë, të humbasë lejen për punë.

#### **Pika 4**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për miratimin e Formularëve të kërkesës për pajtim për ndryshim ose plotësim të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio dhe televizion. Ai ka shpjeguar se sipas nenit 67, paragrafi (6) dhe (7) nga LSHMAAV, transmetuesit janë të detyruar të zbatojnë së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është dhënë leja. Në rast se duan ndryshim ose plotësim të konceptit programor më shumë se 20%, transmetuesi duhet të marrë pëlqimin paraprak nga ASHMA , pra pëlqimin nga Këshilli. Kjo dispozitë e ligjit është që nga fillimi i hyrjes në fuqi dhe deri më tani nuk ka pasur kërkesa nga transmetuesit për ndryshim apo plotësim mbi 20% të konceptit programor. Megjithatë, për të qenë në gjendje të zbatohet kjo mundësi ligjore, është e nevojshme që Këshilli të miratojë formularët në të cilët transmetuesit do të parashtronin kërkesat e duhura për ndryshimin ose plotësimin e më shumë se 20% të konceptit programor nga leja për transmetim në radio dhe televizion. Në këtë drejtim, propozohet miratimi i formularëve të propozuar nga Këshilli.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi formularët me kërkesë për pajtim për ndryshim ose plotësim të më shumë se 20% të konceptit programor të lejes për transmetim në radio dhe televizion, me tekstin siç ishte propozuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, formularët e lartpërmendur duhet t'i publikojnë në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pikat 5 dhe 6**

Z. Petrushevski sugjeroi që për pikat e përmendura të ketë hyrje dhe diskutim të përbashkët sepse bëhet fjalë për të njëjtin medium që ka shkelur 2 nene të Ligjit, dhe pastaj për secilën masë të vërejtjes publike të votohet veçmas. Këshilli e pranoi propozimin.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr.Emilija Janevska shpjegoi Propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV dhe shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media. Ajo ka shpjeguar se këto dy shkelje janë konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt që është bërë në muajin qershor. Kjo është shkelje e të ashtuquajturave detyrime administrative të të dy ligjeve. Në lidhje me pikën 5, ajo shpjegoi se është shkelje e detyrimit të transmetuesit që

të paktën një herë në ditë të sigurojë informacion që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve, pra të mundësojë akses(qasje) të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm të paktën për të dhënat në vijim: emri i plotë i ofruesit të shërbimit mediatik audio, adresa e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio, të dhëna për kontakt (numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe/ose faqja e internetit, personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe organit rregullator kompetent. Të gjitha këto transmetuesi nuk i ka bërë në ditën e analizuar. Në lidhje me pikën 6, ajo shpjegoi se bëhet fjalë për shkelje të detyrimit për sigurim të impresium në përmbajtjet e transmetuara. Për këtë arsye, propozohet shqiptim i masës vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka respektuar Ligjin. Ajo shpjegoi se SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip ka dorëzuar deklaratë që është pjesë përbërëse e materialeve. Lidhur me shkeljen e nenit 51 të LSHMAAV, ai theksoi se bëhet fjalë për gabim softuer, teknik dhe se tashmë është mënjanuar nga ana e tyre, ndërsa për shkeljen e nenit 14 të Ligjit për media, theksojnë se aty ishte shkelje nga ana e drejtuesit të emisionit në renditjen e informacionit të kërkuar në fillim ose në fund të përmbajtjes së transmetuar.

#### Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative nr.10-2549/1 të datës 20.6.2023 dhe njëzëri konstatoi se SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV sepse më 2.6.2023, nuk ka ofruar informacion që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbimet Meditike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptim të masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar)

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojnë në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e rregullt administrative nr.10-2548 /1 të datës 20.06.2023 dhe njëzëri konkludoi ndaj SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media, sepse më 2.6.2023, në emisionin "Pushime me Anxhelën", nuk ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmetojë në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Në pajtim me pikën 7 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptim të masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojnë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 7**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 të LSHMAAV. Ai shpjegoi se operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik kanë detyrim ligjor që të ritransmetojnë shërbime programore të shërbimit publik, por ky operator për një periudhë të gjatë kohore ritransmeton vetëm shërbimin e parë programor "MRT1", ndërsa pjesën tjetër "MRT 2", "MRT 3", "MRT 4" dhe "MRT 5" nuk i ritransmeton. Kjo shkelje është konstatuar për herë të dytë këtë vit, andaj sugjerohet që në pajtim me Ligjin të inicohet procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor nr. 11-2839/1, datë 14.7.2023, të Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, ku është konstatuar shkelja e nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup të iniciojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja është konstatuar se operatori në fjalë i rrjetit publik të komunikimit elektronik, i cili sipas njoftimit të Agjencisë për komunikime elektronike mund të kryej veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shërbimin e tij programor nuk ka ofruar shërbimet programore të shërbimit publik transmetues gjegjësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore "MRT 2", "MRT 3", "MRT 4" dhe "MRT 5", gjë që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektori për çështje juridike duhet të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për operatorin në fjalë.

## **Pika 8**

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënie miratim për aprovim të Vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Ajo shpjegoi se në vitin 2015, Këshilli miratoi Vendim për blerjen e dy aparateve për kafe që kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme. Ajo deklaroi se kjo kontratë lidhet çdo vit, dhe në kuadër të materialeve është dorëzuar për inspektim Propozim-vendimi, me të cilin propozohet të pranohet oferta e kompanisë (firmës) FRIGOTERM TREJD SHPKNJP Shkup, shuma e përgjithshme e së cilës është 56.661,00 denarë pa TVSH, që do të thotë se i përshtatet kufirit nën 1000 euro në vlerë ekuivalente në denarë, gjegjësisht vlerë e parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për Furnizim Publik. Informoi se në këtë çmim përveç shërbimit për

mirëmbajtje, dorëzohen edhe 53 kg. kafe ekspres që do të përdoret për aparatet e specifikuar të kafesë.

Z. Trajçev tha se edhe pse Këshilli jep vetëm miratim për nevojën e furnizimit dhe shumën, ai në parim deklaroi se do të ishte më mirë për furnizim të mirret më shumë se një ofertë për të përcaktuar se cili çmim është më i përshtatshëm për të zgjedhur. Edhe pse Këshilli nuk hyn në përzgjedhjen e ofertuesit dhe mënyrën se si do të lidhet kontrata, megjithatë ka theksuar se është dorëzuar vetëm një ofertë, sipas tij duhet të jenë së paku tri oferta. Edhe pse shuma është e ulët, në parim bëhet fjalë për shpenzimin e mjeteve (fondeve) shtetërore.

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se praktika e mëparshme e Agjencisë është që të ketë së paku tri oferta, por kësaj radhe nga sektori kompetent ka marrë njoftim se kanë arritur të marrin vetëm një ofertë dhe për këtë arsye është dorëzuar vetëm një ofertë. Ajo theksoi se përkundër faktit se ka një ofertë, kjo nuk paraqet pengesë në aspektin Ligjor për furnizime publike që t'i qasemi realizimit të furnizimit.

Z. Petrushevski tha se do të ishte ideale të kishte tri oferta, por kjo nuk është në kundërshtim me ligjin dhe do të japë mbështetje.

Z. Fidanoski deklaroi se do të japë mbështetje. Ai tha se pajtohet me diskutimin e z. Trajçev në lidhje për tri ofertat, por për të vlen edhe shpjegimi i udhëheqëses Mitrevska.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që Drejtori i Agjencisë të marrë Vendim për furnizimin (prokurimin) e shërbimit - mirëmbajtjes së aparateve për kafe të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, i cili nuk do të kalojë shumën prej 60.960,00 denarë me TVSH, në periudhë prej një viti.

Për zbatimin e shërbimit të mësipërm, fondet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

## **Pika 9**

### **Të ndryshme**

Z. Petrushevski tha se i dënon ashpër kërcënimet e drejtuar ndaj drejtorit të Agjencisë, z. Zoran Trajçevski nga një person anonim. Ai tha se kjo nuk është mënyrë komunikimi, sepse duhet komunikuar me argumente. S'është e domosdoshme që dhe të tjerët të pajtohen me Këshillin, por të drejtosh kërcënime është krejtësisht e papranueshme, veçanërisht të dërguara personalisht në celular dhe anonim. Ai shpreson se policia së shpejti do ta zbardhë rastin dhe do të identifikojnë (gjejnë) personin anonim. Ai theksoi se kjo ngjarje e papëlqyer nuk është më aktuale në media, ka zgjatur më pak se një ditë, por është i sigurt që askush nuk është ndjerë mirë, as drejtori, as anëtarët e Këshillit dhe nuk dëshiron që askush në të ardhmen të marrë mesazhe me përmbajtje kërcënuese, sepse kjo për të është krejtësisht e papranueshme.

Z. Ajdini tha se jep i përkrahje të plotë drejtorit Trajçevski për punën e tij në Agjenci. Shpreh keqardhje që e gjithë barra ra mbi të, edhe pse Këshilli ishte ai që mori Vendim për të mos i'u hequr leja, gjegjësisht për të refuzuar Kërkesën anonime për iniciativë për heqje të lejes ndaj TV Alsat. Është për të ardhur keq që ende ka njerëz që mendojnë se me kërcënime

dhe frikësime do t'i arrijnë qëllimet e tyre. Ai ka shpjeguar se përkundër gjithçkaje, Këshilli edhe në të ardhmen do të vazhdojë punën e tij në pajtim me parimet e Ligjit.

Z. Fidanoski dënoi kërcënimet anonime drejtuar ndaj drejtorit Trajçevski. Ai tha se kërcënimin ndaj drejtorit e percepton dhe si kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj Këshillit dhe Agjencisë si institucion. Si anëtarë të Këshillit, ata shpesh kishin mendime të ndryshme për çështje të caktuara që ishin në Rend dite gjatë një seance, ndoshta ndonjëherë kanë pasur edhe debata më të ashpër, por asnjëherë nuk kanë qenë mjet i presioneve dhe kërcënimeve për t'u frikësuar për jetën e tyre ose jetën e të afërmeve (familjarëve). Për këto arsye, ai e dënoi ashpër një akt të tillë. Ai beson se organet e rendit me sukses do ta përfundojnë punën dhe se do të gjendet dërguesi anonim i kërcënimeve.

Z. Trajçev tha se nuk ishte i informuar për ngjarjen dhe tani ka marrë vesh se për çfarë bëhet fjalë. Siç kuptoi, ka pasur kërcënim drejtuar ndaj drejtorit të Agjencisë, të cilin ai e dënon ashpër dhe i jep përkrahje të plotë z. Trajçevski. Ai tha se jetojmë në një vend demokratik ku sundon sistemi i drejtësisë (ligjor) dhe mënyra të tilla komunikimi janë të palejueshme dhe të papranueshme. Ai shpreson se autoritetet do të veprojnë në përputhje me rrethanat dhe do të ndër marrin masat e duhura për zbardhjen e rastit.

**Nr.02-2865/8**

**21.07.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit ,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**